VENDIM
Nr. 103, datë 7.11.2014

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "SA'GA-MAT" SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a"; 9 dhe 13 pika 1, germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "g"; 13 dhe 14, të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "SA'GA-MAT" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "SA'GA-MAT" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

-Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10 germat "a", "b" dhe "c") janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "SA'GA-MAT" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti